REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 2101 Prot Gjirokastër, më 24.11.2026

MIRATOI
REKTORI
Prof. dr. Jaho CANA

Lënda: Hapet thirrja për aplikim për financimin e Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH 2027) nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)

Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka hapur thirrje të reja për projekt propozime, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	Thirrje për aplikim për projekte të infrastrukturës së kërkimit shkencor (PIKSH) për vitin 2027	**05/02/2027**

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, shpall Thirrjen për financimin e Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor – PIKSH 2027, me synim mbështetjen e krijimit, modernizimit, zgjerimit, integrimit dhe funksionalizimit të infrastrukturës së kërkimit shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.
Thirrja synon të mbështesë investimet që kontribuojnë në rritjen e cilësisë, kapaciteteve dhe konkurrueshmërisë së kërkimit shkencor, përmirësimin e përdorimit të përbashkët të burimeve kërkimore dhe krijimin e një ndikimi të qëndrueshëm institucional dhe kombëtar.

Qëllimi i thirrjes

Qëllimi i kësaj thirrjeje është forcimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, nëpërmjet investimeve për krijimin, modernizimin,

zgjerimin, integrimin dhe funksionalizimin e kapaciteteve infrastrukturore kërkimore.
Nëpërmjet kësaj thirrjeje synohet rritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së kërkimit shkencor, përmirësimi i aksesit dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës nga komuniteti akademik dhe kërkimor, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së investimeve në afatgjatë.
Një vëmendje e veçantë i kushtohet nevojës për investime të argumentuara, përdorimit efektiv të infrastrukturës për qëllime kërkimore, realizueshmërisë teknike dhe financiare, aksesit të hapur dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Fushat Prioritare

Kjo thirrje mbështet zhvillimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor në të gjitha fushat e kërkimit shkencor, në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare dhe objektivat e zhvillimit të kërkimit dhe inovacionit, përfshirë:

- Shkencat natyrore dhe inxhinierike;
- Shkencat e jetës dhe shëndetit;
- Bujqësinë dhe mjedisin;
- Shkencat shoqërore dhe humane;
- Teknologjinë, inovacionin dhe transformimin digjital.

Në kuadër të këtyre fushave, mbështetja synon investime infrastrukturore që krijojnë mundësi të reja kërkimore, përmirësojnë kapacitetet ekzistuese dhe nxisin përdorimin e përbashkët të burimeve dhe pajisjeve kërkimore.

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin zyrtar të Agjensisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI): (https://rinia.gov.al/thirrja-e-pare-per-projekt-propozime-grupet-joformale-rinore/)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv/Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Prof. Asoc. Merita Isaraj